

VENDIM
Nr.312, datë 18.4.2020

**PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
DHËNIEN E PËLQIMIT PËR ZGJATJEN E GJENDJES SË FATKEQËSISË
NATYRORE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.243, DATË 24.3.2020, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të neneve 100 dhe 174, pika 2, të Kushtetutës, dhe të shkronjës “d”, të nenit 18, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shpallur me vendimin nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, deri në datën 23.6.2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama